

Njoftim për përqendrim me të cilin STRABAG AG, Austri dhe ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) V-A B.V., Holandë do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság, Hungari (Lënda nr. 08-91/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 21.05.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin STRABAG AG, me seli të regjistruar në adresën Ortenburgerstraße 27, A-9800 Spittal an der Drau, Austri, dhe ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) V-A B.V., me seli të regjistruar në adresën Zuidplein 166, 1077 XV Amsterdam, Holandë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság, me seli të regjistruar në rr. Budafoki 91-93, ndërtesa C, kati 5, 1117 Budapest, Hungari, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

STRABAG AG është pjesë e Grupit STRABAG, i cili është aktiv në industrinë e ndërtimit dhe ka selinë në Austri. STRABAG AG zotëron 50% të aksioneve në MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe ka kontroll individual (negativ) mbi këtë shoqëri. Aktivitetet kryesore të Grupit STRABAG janë: (i) ndërtimtaria dhe ndërtimi i objekteve infrastrukturore (ndërtimi i rrugëve, hekurudhave dhe tuneleve); (ii) ndërtimi i objekteve të larta dhe zhvillimi i patundshmërive; (iii) projekte të specializuara inxhinierike dhe infrastrukturore; dhe (iv) shërbime mjedisore dhe industriale. Grupi STRABAG është aktiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes projekteve të ndryshme infrastrukturore dhe ndërtimore.

Grupi STRABAG ka filialet e mëposhtme të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- (i) STRABAG Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar Poloni – Filiali STRABAG Shkup, me veprimtari kryesore prioritare 42.12 – Ndërtimi i hekurudhave dhe hekurudhave nëntokësore;
- (ii) STRABAG D.O.O. Beograd – Filiali STRABAG Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari kryesore prioritare 42.11 – Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave;
- (iii) STRABAG AG – Filiali STRABAG Shkup, me veprimtari kryesore prioritare 42.11 – Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave;
- (iv) Shoqëria për shërbime STRABAG SHPKNJ Shkup, me veprimtari kryesore prioritare 41.00 – Ndërtimi i ndërtesave banesore dhe jo banesore; dhe
- (v) CML Construction Services d.o.o. Beograd – Novi Beograd – Filiala Shkup, me veprimtari kryesore prioritare 70.20 – Veprimtari këshillimore lidhur me afarizmin dhe menaxhimin tjetër.

ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) V-A B.V. është pjesë e Grupit më të gjerë Aberdeen, një grup ndërkombëtar për shërbime financiare dhe menaxhim të mjeteve me seli në Mbretërinë e Bashkuar. Aktivitetet kryesore të Grupit Aberdeen përfshijnë: (i) menaxhimin e mjeteve dhe zgjidhje investuese; (ii) menaxhimin e pasurisë dhe produkte kursimi për klientë individualë dhe institucionalë; dhe (iii) zhvillimin dhe menaxhimin e platformave digjitale të

investimeve dhe shërbimeve këshillimore. Përveç kësaj, Grupi Aberdeen është i angazhuar edhe në: (i) zgjidhje për pensione dhe sigurime pensionale; (ii) strategji investimi multi-asetesh dhe alternative; dhe (iii) ofrimin e shërbimeve për planifikim financiar dhe ndërmjetësim. Grupi Aberdeen zotëron 20% të aksioneve në MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság. Grupi Aberdeen nuk ka aktivitete afariste dhe as filiale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

MAK Mecsek Autópálya Koncessziós Zártkörűen Működő Részvénytársaság menaxhon një segment të autostradës M6 në Hungari në bazë të një marrëveshjeje koncesioni e cila është në fuqi deri në vitin 2037. Shoqëria e synuar nuk ka aktivitete afariste dhe as filiale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant të përcaktohet si tregu për menaxhimin e infrastrukturës transportuese në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraparak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

26.05.2026

Shkup